

Trajnim i zhvilluar në kuadër të popullimit të platformës elektronike për korrupsionin dhe krimin e organizuar

Shërbimet e Komisionit Evropian në kuadrin të mbështetjes së kapaciteteve të vendeve kandidatë/kandidate potenciale, për të mbledhur dhe raportuar në mënyrë konsistente dhe të plotë, të dhënat në lidhje me historikun e ndjekjeve dhe dënimeve penale, kanë krijuar një platformë të re elektronike për mbledhjen, raportimin dhe përpunimin e informacionit të raportuar nga shtetet në kuadrin e veprave penale të përcaktuara.

Në 17 tetor 2023 u mbajt trajnimi i rradhës për të gjitha vendet kandidatë ku morën pjesë përfaqësues nga gjykatat dhe prokuroritë e vendit, ILDKPKI, AAPSK, MB dhe MD. Gjatë trajnimit përdorusit u informuan rreth specifikave që paraqet kjo platformë, ofruan asistencë për sa i përket disa çështjeve teknike për hedhjen e të dhënave si dhe diskutuan me të gjithë përdorusit për sa i përket përmirësimeve të mundshme që mund të kryhen në këtë platformë e cila përmbush standardet më të larta të sigurisë për sa i përket të dhënave të hedhura.

